

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. S nga Gj, për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar në shërbime komunale nga neni 321 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1220/2016, të datës 25.07.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 16.05.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **R.S** nga i ati O e ëma H, e lindur S ,i lindur në fsh., me vendbanim në Gjilan, Rr. ” përballë spitalit, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar-baba i 7 fëmijëve, i gjendjes ekonomike të varfër, veteran i luftës, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 20 Gusht 2015, në rrugën “, pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit, nga punëtorët e autorizuar të është konstatuar se, i pandehuri, në shtëpinë e tij si shfrytëzues i energjisë elektrike, në mënyrë të paautorizuar është rilidhur në mënyrë direkte pa njehsor në rrjetin elektrik të KEDS, edhe pse i njëjti është ç’kytur nga rrjeti elektrik për shkak të mos pagesës së borxhit ndaj KEDS për energjinë e shpenzuar elektrike, kështu që i pandehuri me veprimet e tij e ka dëmtuar, të dëmtuarën KEDS-Distrikti në në vlerë prej rreth 633 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime komunale nga neni 321 të KPRK, Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit, i shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqindë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-s, i akuzuari Ragip Sadiku lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartë cekur ndaj të akuzuarit nga Gj për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar në shërbime komunale nga neni 321 të KPRK-s,

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 16.05.2017 Prokurori i Shtetit, Kujtesa Fazliu deklaron: me vetë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajin dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPK-s , gjendja faktike lidhur me këtë vepër penale tani më nuk është kontestuese. Mbi këtë gjendje faktike rezultojnë edhe elementet themelore të veprës penale të kualifikuara në aspektin juridik lidhja e pa autorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së. Prandaj bazuar në pranimin e fajësisë si dhe të provave materiale të cilat ndodhen në shkresat e

lëndës i propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale si dhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale, gjithashtu i propozojmë gjykatës që me rastin e përcaktimit e llojit dhe lartësisë e dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

I pandehuri ku, deklaroi: e ndijë veten fajtor, pendohem për këtë veprë dhe i premtojë gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, këtë veprë e kam kryer pasi që deri atëherë QPS si rast social ma ka paguar energjinë elektrike, ndërsa pas kësaj ata nuk ma kanë paguar borxhin e mbetur të energjisë elektrike dhe punëtorët e për shkak të borxhit ma kanë marrë një sorin elektrik dhe unë pasi që i kam fëmijët e vegjël nuk kam mundur të rri pa energji elektrike dhe e kam lidhur energjinë elektrike direkt pa një sor dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike nga neni 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari, ka kryer veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime komunale nga neni 321 të KPRK-s,

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin, për shkak të kryerjes së veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; sjelljen korrekte në gjykatë, se është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese dashjen për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit kumulativ me kusht, ndaj të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shëndrruar në dënim efektiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-s, i akuzuari lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 911/2016, Më 16.05.2017

Sekretarja juridike,

Igballe Azemi d.v

Gjyqtari

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.